



RAPORTI I PUNËS

01 janar 2022 - 20 prill 2023

Gjenevë, 20 prill 2023

AKTIVITETET

1. Misioni i informimit

Periudha pandemike sikur ka lënë gjurmë të thella në aktivitete të shumë shoqatave të cilat ende nuk e kanë rimarrë mirë vetën. Prandaj edhe kanë munguar aktivitete më të ngjeshura.

Megjithatë, informimi i bashkëkombësve tanë në Gjenevë mbi ngjarjet e ndryshme kulturore, sportive dhe të tjera mbetet edhe më tutje një nga objektivat e rëndësishëm për Komunitetin Shqiptar të Gjenevës. Kjo bëhet nëpërmjet postës elektronike meqenëse disponojmë me disa qindra adresa, sikurse edhe me sajtin tonë në internet.



2. Pjesëmarrja në Aulona-Inter-Folk Festival në Vlorë

Festivali tradicional që mbledh grupet folklorike nga shumë vende të botës kësaj radhe ka mirëpritur edhe grupin "Hareja" që vepron në kuadër të Komuniteti Shqiptar të Gjenevës. KShGj edhe e ka ndihmuar financiarisht me 1'000CHF, kurse ansambli "Gëzuar" e ka ndihmuar me 300CHF. Për një paraqitje të shkëlqyer u nderuan edhe me mirënjohje nga organizatori i festivalit.



3. Shfaqja e filmit artistik "Bolero në vilën e pleqve"

Në kuadër të Festivalit Ndërkombëtar të Filmit Oriental që mbahet tradicionalisht në Gjenevë, kemi kontribuar në mënyrë aktive dhe financiare në përzgjedhjen e filmit "Bolero në vilën e pleqve" me aktorët e njohur Robert Ndrenika dhe Margarita Xhepa, sikurse edhe me aktoren e re nga Shkupi Gentiana Ramadani e cila ishte edhe mysafire e jonë gjatë qëndrimit në festival. Filmi u shfaq në kinemanë "Grutli" me një numër të kënaqshëm të shikuesve. Pas shfaqjes së filmit KShGj ofroi edhe një aperitiv.

4. Festa e Flamurit dhe 110 vjetori i Pavarësisë së Shqipërisë

Festa e Flamurit këtë vit është shënuar me një program të larmishëm, i mbështetur ekskluzivisht në forcat tona lokale artistike dhe me pjesëmarrjen masive të publikut. Në program morën pjesë fëmijët e LAPSh-ës, grupet artistike nga Gjeneva: RiniaKontakt, Grupi Hareja dhe Gëzuar, sikurse edhe artistët Afërdita dhe Shpejtim Krasniqi, Drita Sahiti, Bardh Ramadani, Elion Krasniqi dhe Evin Thana me Véronique Aeschmann.



Në organizim ka pasur edhe vullnetarë që na kanë ndihmuar në mbajtjen e rendit dhe shitjes së pijeve në bar (Vllaznim Bityqi dhe Gafurr Dashi me punëtorët e vet). Si zakonisht, edhe këtë vit "Aligro" na ka ndihmuar me 300fr.

Si zakonisht, edhe këtë vit është bërë prezantimi i studentëve shqiptar nga Gjeneva, të posa diplomuar në nivelin master nëpër Universitete zvicerane të cilëve iu nda nga një mirënjohje për përmasimin e imazhit tonë në Gjenevë dhe Zvicër. Edhe më tutje mbetet problem gjetja e këtyre studentëve dhe ardhja e tyre në manifestim. Pra, në këtë pikë presim bashkëpunim më të gjerë.

5. Koncert me Grupin polifonik nga Vlora

Kërkesa e dërguar Loterie Romand për ndihmë financiare për realizimin e ardhjes në Gjenevë të grupit polifonik "Bilbili" nga Vlora, ka hasur në mirëkuptim, duke marrë në konsideratë

vlërën e polifonisë shqiptare që është e aprovuar sikur pasuri kulturore jomateriale botërore e shpallur nga UNESCO. Ndihma e tyre prej 7 mijë franga ishte afër gjysmës së shumës së nevojshme. Pjesa tjetër është siguruar nga shitja e biletave dhe nga fondi i KShGj-së. Përveç kësaj ndihmë të rëndësishme na kanë ofrua edhe shoqatat "Iliria" nga Saint-Julien-en-Genevois, RiniaKontakt dhe ansambli "Gëzuar" që ju kanë ofruar disa herë darka dhe dreka mysafirëve tanë që nuk ishin të pakët në numër.



6. Pjesëmarrja në Festën e Valleve në Çifite (Civita) të Kalabrisë - Itali

Me ftesë të organizatorit, që është komuna Çifite në Kalabri, grupi "Hareja" ka marrë pjesë në festën tradicionale disa shekullore që mbahet në këtë fshat arbëresh. Me pjesëmarrje në një koncert dhe me defile me veshje kombëtare të shumë grupeve folklorike nga shumë fshatra të Kalabrisë. Me vizita në disa fshatra të tjerë të Kalabrisë dhe me vizitë në Bibliotekën e At Antonio Belushit.





At Antonio Belushi është një prift ortodoks që ruan dhe kultivon gjuhën e vjetër shqipe, nga koha e Gjergj Kastriotit Skënderbeut (arbërishtën)

Kryetarja e KShGj dhe njëkohësisht edhe udhëheqëse e grupit "Hareja" u nderua edhe me një mirënjohje nga kryetari i komunës Civita z. Alessandro Tocci, për pjesëmarrje në këtë festë të madhe.

Gjenevë, 20 prill 202

Sekretar

Ali Mehmeti

Kryetare

Afërdita Krasniqi